



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
MINISTRI

Nr. 1301 prot.

Tiranë, më 08.03/2020

**URDHËR**

Nr. 133, datë 08.03, 2020

**PËR**

**KUFIZIMIN E LËVIZJES SË SHOQËRUESVE DHE/OSE FAMILJARËVE TË  
PACIENTËVE NËPËR SPITALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit 10107 datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshura, të nenit 7 të Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Vendimit të datës 8.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri" si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

**URDHËR O J:**

1. Në ambientet e shërbimeve të urgjencës mjekësore në institucionet e kujdesit shëndetësor ndalohet hyrja e shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore.
2. Në ambientet e shërbimit spitalor ku janë duke marrë trajtimin spitalor pacientët ndalohet hyrja e shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, strukturat shëndetësore të urgjencave mjekësore dhe atyre spitalore si dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

*Ogerta Manastirliu*